



Qendra e kontaktit  
për parandalimin  
e ekstremizmit dhe  
dhunës

**Biel**  
**Bienne**

## Oferta jonë

Qendra e kontaktit për parandalimin e ekstremizmit dhe dhunës të Qytetit Bienne, këshillon drejtpërdrejt qytetarët dhe shërbimet administrative në lidhje me ekstremizmin dhe radikalizimin, ose i vë ata në kontakt / lidhje me organet kompetente si: (policinë, Solidariteti i grave, Ndihma për viktimat, etj) për sa i përket temave të tjera në lidhje me parandalimin e dhunës (dhuna në familje, rreziku i menjëhershëm i dhunës, kërcënime ndaj autoriteteve dhe shërbimeve publike, etj.)

## Karakteristikat e ekstremizmit dhe të radikalizimit

Ekstremizmi mund të marrë forma të shumta. Radikalizimi mund të ketë një origjinë sociale, politike ose fetare. Ai mund të çojë deri në pikën që të jemi të gatshëm të ndjekim një besim ose një vizion për botën që mund të besojmë të jetë i vetmi i drejtë deri në atë pikë sa t'i japim vlerë me anë të dhunës.

Pozicionet ekstremiste karakterizohen si më poshtë:

- Absolutizmi: « E vetmja e vërtetë është ajo që ne paraqesim! »
- Kriteri « mik-armik »: « Çdokush që nuk është me ne, është kundër nesh! »
- Zhvlerësimi i kundërshtarëve dhe besimtarëve të besimeve të tjera.
- Hedhja poshtë e rregullit demokratik dhe të institucioneve të tij.
- Mistifikimi i figurave emblematike.
- Alternim i thellë i personalitetit, rast i zbatueshëm i cili lidhet me izolimin shoqëror të personit përkatës.
- Transformim i paraqitjes së jashtme ose i mënyrës së veshjes.

Shpesh, këta lloj personash, ndodhen në situata krize (p.sh.: lidhje, punë, përjashtim, çrrënjosje, financa, etj.). Ata gjenden në një fazë orientimi, pozicionimi dhe anëtarësimi ideologjik radikal.

## Grupet e synuara

Qendra e kontaktit për parandalimin e ekstremizmit dhe dhunës, i ka dyert e hapura për të gjithë popullsinë dhe organet e Administratës komunale të Bienne.

Ajo dallon grupet e synuara të poshtëshënuara:

- Personat në fazë radikalizimi ose tashmë të radikalizuar, por të cilët nuk paraqesin një rrezik të menjëhershëm.
- Personat të cilët dëshirojnë t'i largohen një skene ekstremiste.
- Prindër dhe persona të tjerë të shqetësuar nga radikalizimi i mundshëm i partnerit të tyre, ose të fëmijëve, miqve, të njohurve.
- Zyrat dhe organet publike si dhe specialistët e tyre (mësues, punonjës socialë të shkollës, pedagogë socialë, anëtarë të shërbimit të shëndetit, etj.)

## Oferta dhe këshilla

Këshillat jepen si më poshtë:

- Këshilla personale me telefon ose me shkrim (e-mail)
- Këshilla në frëngjisht, në gjermanisht dhe, nëse është e nevojshme, edhe në gjuhë të tjera me ndihmën e një perkthyesi.
- Zyra për bashkëbisedime anonime, konfidenciale.
- Vënia në kontakt me specialistët e angazhuar për ofertat / ndihmat e adaptuara sipas nevojës.
- Këshillime falas.

## Na kontaktoni si më poshtë

Ortspolizei / SIP der Stadt Biel  
Ansprechstelle Extremismus– und Gewaltprävention  
Neuengasse 28 / Rue Neuve 28  
2501 Biel / Bienne  
T: +41 32 326 18 80  
ansprechstelle-eg@biel-bienne.ch